



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 09/2011
Prishtinë, më 10.05.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Mungoi : Fikrim Damka.

Të ftuarit për raportim: Osman Ejupi, kryetari i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës dhe Ahmet Krasniqi, nënkryetari i Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës.

Pjesëmarrës të tjerë: Haxhi Gashi- USAID dhe Besnik Ramadanaj – KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina. dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 03.05.2011;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës; 03.05.2011

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 03.05.2011, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2010

Kryetari – theksoj se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, ku do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës për vitin 2010 kemi ftuar kryetarin e Bordit z. Ejupi, i cili do të paraqet një ekspozë të shkurtë për këtë Raport.

Osman Ejupi (kryesues i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës -AKK)- AKK-ja ka nisur vitin e dytë të punës së tij duke u bazuar në eksperiencën e fituar në ushtrimin e veprimtarisë së vet, gjatë vitit 2010, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë mbrojtjes së konkurrencës dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin e Ligji Nr.2004/36 “Për Konkurrencën”, datë 8 shtator 2004., si dhe punës gjatë gjithë vitit për draftimin e ligjit të ri, Ligji nr.03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe është në fuqi nga 10 Dhjetor 2010. Theksoje që objektivi kryesor që ka ky institucion, pra Autoriteti i Kosovës i Konkurrencës, (AKK) është të ruajë dhe të nxisë konkurrencën, duke mbrojtur lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve të ndryshëm në treg, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të sjelljes së tyre. Draftimi i ligjit të ri për mbrojtjen e konkurrencës, ishte një objektivi shumë i rëndësishëm i AAK-se, sepse ishte imperativ për tregun e Kosovës por gjithashtu ishte edhe kërkesë për harmonizimin e plotë me legjislacionin e BE-së, respektivisht legjislacionin për mbrojtjen e Konkurrencës. Tani me hyrjen në fuqi të këtij ligji munde të themi se në tregun e Kosovës, institucioni për mbrojtjen e Konkurrencës është plotësisht kompatibil dhe njësoj i avancuar me vendet më përvojë në regjion dhe më gjere. Këtë e kemi dëshmuar edhe me raportet tona në drejtorin Gjeneralë të Konkurrencës në Bruksel, ku jemi inkurajuar për një fillim të mirë dhe të mbare të mbrojtjes së tregut në fushën e konkurrencës. Aktivitete të tjera të përgjithshme të politikës së konkurrencës janë gjithashtu parandalimi i abuzimit me pozicionin dominues, apo siç quhet shpesh me fuqinë në treg, ndërprerja e marrëveshjeve me pasoja të rënda për konkurrencën si në nivel prodhimi, shërbimi apo dhe tregtimi dhe mbrojtja e konsumatorëve dhe respektimi i konkurrencës së lirë. Politika e konkurrencës nuk duhet parë e shkëputur nga politikat e tjera ekonomike, të tilla si ato tregtare, antidumping, ndihma shtetërore, kufizimet në eksport, politikat industriale, të zhvillimit rajonal, pronësisë industriale, të privatizimit, zhvillimit shkencor e teknologjik, të investimeve dhe taksave, marrëdhënie të cilat gjejnë pasqyrim në ligjet respektive. Mbrojtjen e konkurrencës do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë duke parë se deri në ç’masë mund të arrihen objektivat e ligjit të konkurrencës, pa u detyruar të kufizohen apo të bien ndesh me objektivat e ligjeve të tjera, duke rritur kështu mirëqenien e konsumatorit vendas, përmirësimin e konkurrueshmërisë në ekonomi, heqjen e pengesave në tregun kombëtar, rajonal e më gjerë. Në këtë kontekst mund të themi se aq sa konkurrenca ndihmon konsumatorët, po aq konsumatorët mund ta ndihmojnë konkurrencën, duke pasur kështu një marrëdhënie mbështetjeje të ndërsjellët. Një ekonomi tregu që të jetë funksionale dhe e suksesshme ka si kusht veprimin e të gjitha ligjeve. Këto ligje janë të nevojshme për të realizuar përfitimet që sjell ekonomia e tregut dhe tregtia e lirë. Ligji i konkurrencës mbron tregun duke shmangur dhe penguar jo vetëm praktikën e parregullta të

subjekteve private, por edhe nga ndërhyrjet e shtetit nëpërmjet akteve normative të ndërmarrja prej tij. Zbatimi i suksesshëm i ligjit të konkurrencës kërkon jo vetëm njohuri teknike, por edhe eksperiencë të mjaftueshme. Për të qenë të suksesshëm në realizimin e kësaj politike, për zbatimin e ligjit, veprimtaria jonë do të karakterizohen nga pavarësia, transparencja, profesionalizmi dhe efektiviteti. Në themel të ligjit të konkurrencës është kryesisht parandalimi ose ndalimi i tre lloj praktikave: 1. Marrëveshjet e ndaluara, antikonkurrese, veçanërisht kartelet që fiksojnë çmimin ose ndajnë tregjet; 2. Abuzimi me pozitën dominuese (që njihet ndryshe si monopol), kur ndërmarrjet në mënyrë të vetëdijshme nëpërmjet caktimit të çmimeve mbi nivelet konkurrese, ruajnë apo forcojnë fuqinë e tyre në treg, duke krijuar kështu pengesa për hyrësit e rinj apo daljen e konkurrentëve më të vegjël nga tregu; dhe 3. Përqendrimet apo bashkimet antikonkurrese. Zbatimi i këtyre praktikave të pandershme që lejojnë krijimin e monopoleve de fakto, bëjnë rritjen e çmimeve për konsumatorin, uljen e prodhimit, zvogëlimin e mundësisë së zgjedhjes së produkteve, zvogëlimin e novacionit, shërbimit ndaj klientit dhe në përgjithësi në ulje drastike të mirëqenies së konsumatorit. Autoriteti i Konkurrencës e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion publik, i pavarur, me mision mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për një treg sa më funksional, me synimin final realizimin e përfitimeve sa më të mëdha të mundshme për konsumatorët. Realizimi i këtij misioni është mundësuar nëpërmjet veprimit sipas vizionit të Komisionit të Konkurrencës i cili konsiston në vlerësimin në mënyrë sa më objektive të sjelljes së operatorëve në treg dhe të efekteve të akteve normative në funksionimin e tregut. Gjithashtu realizimi i këtij misioni mbështetet në praktikën më të mira të eksperiencës europiane e më gjerë, si dhe në specifikat e ekonomisë kosovare si: madhësia e tregut, masa e informalitetit, etj. Ky vizion është konkretizuar nëpërmjet përcaktimit të objektivave të cilat janë realizuar nëpërmjet një diskutimi gjithëpërfshirës të strukturës së Autoritetit të Konkurrencës. Këto objektivat janë: krijimi i një stafi të kualifikuar me njohuri të thella në fushën e ekonomisë dhe të së drejtës, që të jetë i aftë të aplikojë metodologji, të kryejë studime dhe të realizojë investigime në terren në zbatim të ligjit; sigurimi i një transparence të plotë në procedurat e ndjekura të vendimmarrjes dhe të zbatimit të detyrave të tij funksionale, bashkëpunimi i ngushtë me entet rregullatore, institucionet qëndrore e vendore dhe autoritetet gjyqësore dhe; udhëheqja nga parimet e drejtësisë, të barazisë dhe paanshmerisë në zbatimin e detyrave të tij funksionale.

Kryetari – theksoj se tashme prej dhjetorit kemi një ligj të ri për mbrojtjen e konkurrencës, dhe u tha që ju nxjerr në një agjencion në të cilin jeni kompatibil me institucionet tjera të regjionit, dhe me përputhje me standardet e BE-së, a keni kryer ndonjë aktivitet konkret sipas ligjit të ri?

Osman Ejupi (kryesues i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës -AKK) - me aprovimin e ligjit të ri edhe me futjen e shtyllës së tretë e cila ka të bëjë me përqendrimet aktiviteti i ri, është një kërkesë e një operatori ekonomik nga Shqipëria, e cila i ka disa njësi këtu në Kosovë, që në ta vlersojmë se a mund të kryhet përqendrimi i atyre ndërmarrjeve nga Shqipëria, Mali i zi dhe nga Maqedonia, edhe jemi në përpunim të këtijë rasti që ta japim mendimin tonë profesional.

Teuta Sahatqia – pyeti se cilët janë ata indikatorët me të cilët mirreni ju, për një lëndë apo çështje për tu trajtuar? A është analiza e juaj apo është ndonjë indikator tjetër i cili vjen dhe ju ankohet? Përmendet çështjen e bankave, lidhur me këtë çështje kërkoj më shumë sqarime rreth rreth kamatave të larta, sepse u përmend që keni filluar një analizë, deri ku ka mbërri? Aviokompanitë të cilat operojnë në Kosovë, janë kompani të cilat japin bileta me çmime më të larta, a keni ndërhy deri më sot? Tek shqiptimi i gjobave, a duhet të bëhen me udhëzim administrativ apo si analizoni dhe si vendosni për nivelin e gjobës për një dënim të caktuar?

Hashim Deshishku - tha që sipas raportit të prezentuar të punës del se ky autoritet i ri edhe më tutje është në fazën e krijimit të përvojës, kompletimit me akte nënligjore, dhe përgatitjes stafit. Hetimi në tregun e karburanteve, është fjala për një marrëveshje gojore, si thuhet në raport, ndërmjet tregtarëve të karburanteve në rajonin e Gjilanit, nuk ka asnjë dëshmi të shkruar se ka

ekzistuar marrëveshja, Komisionin nuk ka marrë parasysh kushtet e tregut meqenëse këto biznese kanë mundur të kanë të njëjtin furnizues dhe punojnë në kondita të njëjta të tregut. Nga kjo është e logjikshme që çmimet të jenë të njëjta apo përafërsisht të njëjta, më shumë ka të bëjë me një propozim. Meqenëse tregu i karburanteve megjithatë mbetet jashtë kontrollit dhe me mjaft dyshime për marrëveshje të fshehta të cilat vështirë se mund të identifikohen atëherë duhet gjetur një mekanizëm më efikas. Nëse i shohemi përvojat e gati të gjitha vendeve në rajon të cilat kanë një autoritet rregullator për çmimet. Po përmendi rastin e Sllovenisë ku rregullatoi dy herë në muaj caktonte çmimet e karburanteve dhe me këtë rast ka parasysh çmimin në bursë, kursin e dollarit interesat e bizneseve dhe interesat e konsumatorëve. Thëksoi se kjo praktikë do të ishte e mirëseardhur edhe në Kosovë posaçërisht pse zhvillimi i këtij sektori. Hetimi në tregun e arkave fiskale, një problem i rëndë dhe i rëndësishëm, jo vetëm për biznes por edhe për buxhetin e shtetit. Mirëpo, i tërë procesi ka rrjedh me imponim, përkatësisht bizneseit nuk i është ofruar mundësia që të zgjedhë shërbime më cilësore dhe çmime më të arsyeshme. Tha se ndërhyrja e Komisionit të Konkurrencës ka qenë e arsyeshme, por edhe e vonuar. Nga ana tjetër është dashur të merret më shumë edhe me institucionin që ka licencuar këto dy kompanitë, “Dukagjini” dhe “Gekos”, ka qenë i lirë të veproj sipas vullnetit të vet, të impnoj kushte dhe të krijoj monopol. Ndoshta është i qëndrueshëm arsyetimi i kompanisë “Dukagjini”, por këtë e demanton një fakt tjetër – si ka mundur që laboratorit të jetë efikas në rastin e kompanisë “Gekos”, kurse paska dështuar të “Dukagjini”. Megjithatë, edhe një herë më duhet të shtoj pse Komisioni i Konkurrencës nuk ka insistuar te Ministria e Financave e cila ka licencuar këta operatorë që ajo të kërkojë respektimin e kushteve të licencës, apo të bëjë revokimin e tyre. Qoftë edhe pagesa në kushte pak më të përballueshme, ose po përmendi modelin që ka aplikuar Maqedonia, e cila investimet që bëjnë bizneset deri në dhjetë arka fiskale në fund të vitit iu kthehen përmes lehtësive në tatimin në fitim. Por, ka edhe disa forma të tjera që vërtetë do të ishin të mirëseardhura edhe për tregun tonë si ajo që operatori i licencuar të ketë servis për çdo 600 aparate të instaluar dhe të kushtëzohet që intervenimet të kryhen brenda një afati të caktuar kohor ta zëmë 36 orë sa është në Maqedoni. Hetimi i tregut të sigurimeve, në këtë rast Komisioni i Konkurrencës bën një përpjekje të dështuar për të nxjerrë fajtorë kompanitë e sigurimit si quan ai një “marrëveshje sipas Komisionit e paskan nënshkruar dhjetë kompani të sigurimit gjatë një takimi të mbajtur më 03.07.2009-të në Gjakovë. Aty kompanitë qenkan marrë vesh që citoj – “të mos lejohet kurrfarë zbritje nga kompanitë e sigurimeve njëherë të ruhet tregu i sigurimeve”. A mjaftojnë vetëm këto dy konstatime që të shqiptohet dënimi prej një milionë eurosh. Jo! Pse? Nëse analizohen vetëm këto dy fjali atëherë: E para “të mos lejohet kurrfarë zbritje nga kompanitë e sigurimeve”, nuk do të thotë asgjë tjetër pos ruajtja e konkurrencës fer dhe mbrojtja nga konkurrenca jolojale. Kjo nuk ka asgjë të keqe meqenëse është insistuar të eliminohen veprimet e paligjshme që janë paraqitur në këtë treg; E dyta - “Të ruhet tregu i sigurimeve” është njëra prej fjalive për të cilën ndëshkohen kompanitë. Vërtet e pakupëueshme, meqenëse nuk ka asgjë të keqe nëse ato kanë pasur qëllim ruajtjen dhe forimin e tregut. Këtu ka edhe probleme të tjera të cilat Komisioni i Konkurrencës nuk i ka marrë fare parasysh. Çmimi i polisave për autopërgjegjësinë është i kontrolluar dhe ai caktohet nga Banka Qendrore e Kosovës. Këtë mund ta gjeni në faqen e internetit të BQK-së. Po ashtu çdo sjellje tjetër e kompanive të sigurimit paraqet shkelje të ligjit për të cilat mund të ndëshkohen madje edhe të humbin licencën. Marrëveshja për të cilën flet Komisioni nuk mund të quhet provë pasi që nuk është zyrtare nuk është nënshkruar nga asnjë përfaqësues ligjor i kompanive nuk ka numër protokoli nuk ka as vulë. Prandaj as që mund të jetë dokument apo marrëveshje. Komisioni me këtë rast nuk ka konsultuar bazën ligjore që rregullon fushën e sigurimeve të autopërgjegjësisë ndaj palëve të treta sepse ato tarifa caktohen me një bazë ligjore si është Rregulli 3 i BQK-së. Meqenëse ligji i Konkurrencës është në kolizion me rregulli 3 të BQK-së ndoshta më e mira ka qenë që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës apo edhe ne si Komision Parlamentar të marrin iniciativën që të qartësohen relacionet ndërmjet ligjit për Konkurrencën dhe Rregulli 3 të BQK-së ashtu që të mos pësoj biznesi. Në fund desha të parashtroj edhe tri pyetje: pse vonohet kaq shumë miratimi i akteve nënligjore si është statuti i Autoritetit të Konkurrencës dhe i katër

udhëzimeve administrative? Si mund të punohet në mungesë të statutit dhe të këtyre udhëzimeve, në faqe 39 të raportit financiar thuhet : se për paga dhe mëditje janë shpenzuar 90.082 euro. Në faqe 41 nën kategorinë “mallra dhe shërbime” shkuan se për “shpenzime të udhëtimit” janë paguar gati sa edhe për paga , saktësisht 80.713 euro. Pyeti çfarë nënkupton “shpenzime të udhëtimit” cilat qëllime janë financuar nga kjo kategori dhe sa ka qenë e arsyeshme që për dhjetë veta, pesë komisionar dhe pesë staf teknik, të bëhet kaq shumë shpenzime për udhëtim? Prandaj mendoj se ky raport duhet të kompletohet, të inkorporohen vërejtjet e dhëna e pastaj të miratohet.

Visar Ymeri - theksoj se në raport nuk vërehet që raportohet për disa sfera ku janë bërë shkelje të ligjit të Konkurrencës, për shembull të çështja e Telekomit të ndërhyrja e operatorëve ilegal, brenda territorit të Kosovës, ose është pjesërisht është pasqyruar. Po ashtu edhe e njëjta çështje është te bankat dhe sigurimet, ku ne e dimë që ka pasur shumë shkrime nëpër media edhe sa i përket kamatave të bankave, ato argumente të cilat janë dhënë aty e paraqesin një bazë goxha të mirë të dyshimit, të paktën nëse jo të shkeljes. Po ashtu edhe të dhënia e licencave për miniera dhe minerale. Duke u bazuar në punën të cilën e keni bërë në Gjilan, sa i përket derivateve, a ka pasur ndonjë intervenim të agjencisë së juaj? Sa i përket shitjes së derivateve në pjesën veriore të Kosovës ku çmimet janë shumë më të lira, ku edhe shkaktojnë çrregullim të tregut përmes kontrabandës por edhe përmes dampingut, çfarë masa keni marrë? A keni marrë ndonjë hap për sa i përket zbatimit të masave për antidamping në Kosovë? Po ashtu, si i keni vlersuar apo caktuar gjërat të cilat kanë të bëjnë me arkat fiskale edhe me kompanitë e sigurimeve dhe të derivateve? U pa që gjërat të cilat i keni cekur këtu janë mbi 100 mijë euro, ndërkohë që ligji thotë që sa i përket shkeljeve të rënda të ligjit gjërat duhet të jenë 10% të hyrave të raportuara të kompanisë, për vitin për të cilin po flasim, pra si keni ardhur deri të shuma 100 mijë euro, edhe a e vlersoni se kjo gjë ka qenë e mjaftueshme për ta parandaluar një dukuri të tillë? Rrjedhimisht po qe se ka marrveshje të Gekosit dhe kompanisë së Dukagjinit, që qartazi po shifet se ka, 100 mijë euro nuk e ndalin këtë marrëveshje sepse fitimi ka qenë shumë më i madh. Dhe ata e kanë bërë marrëveshjen duke e pasur parasysh se do ti paguajnë 100 mijë euro dhe konsideroj se në këtë drejtim duhet të ndërmerren masa dhe nëse është ligji i pamjaftueshëm duhet me e ndryshua ligjin, ku e parandalojnë dukurinë e tillë e jo vetëm që e caktojnë një gjë sidomos kur është e një niveli shumë të vogël krhasuar me fitimet që mund të sillen në kompani.

Myzejne Selmani - theksoi se duke u bazuar në ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës e japë të drejtën që të formohet ky agjencion. Unë mund të them se puna e juaj edhe tani edhe në vitin e kaluar është bukur mirë sfiduese për një shtet të ri si është Kosova, edhe për një ekonomi e cila kalon nga një ekonomi e centralizime, në ekonomi të decentralizime. Edhe në këtë raport të juajin paraqitet esenca e juaj ku thuhet se të gjitha ligjet të cilat miratohen në Parlament të jenë për mbrojtjen e konkurrencës. Mirëpo prapë se prapë do të jetë një përgjegjësi e juaj e madhe në të ardhmen që së bashku me të gjitha strukturat organizative që i keni në Agjencionin Kosovar të Konkurrencës të përballeni me tregun edhe të përballeni me monopolin ku mund të ju them shumë drejtë se e keni në secilën lëmi. Mirëpo nuk dua të marrë kohë prandaj dua të them lidhur me tri çështjet të cilat i keni ngritur këtu si hetime të themeluara në tregun e arkave fiskale, në kompanitë e sigurimeve, edhe në çështjet e derivateve, unë mundem me thënë se keni kujdes edhe me ligjet tjera, s’dua të hy në analiza më të thella se z.Deshishku potencoj diçka rreth tyre por une nuk po dua të shkoj në atë pjesë e keni të miratuar edhe ligjin Antidamping në emër të këtij Komisioni Parlamentar. Kemi monopole mjaft. keni shumë punë. mirëpo përkrahja jonë si Komision nuk do të mungon. do të mbetet që ju në të ardhmen ndoshta edhe me një vërejtje adekuate, ndoshta edhe me një gjë të cilën ua mundëson ligji mbi Konkurrencën, të rregulloni sepse ju jeni rregullator mbi zhvillimin e Konkurrencës në Kosovë.

Berat Buzhala – theksoj se çështja e parë është lidhur me hulumtimin e juaj që keni bërë mbi çështjen e karburanteve me pakicë në Gjilan, a keni në plan me hulumtuar kompanitë që janë të

licencuara për import të naftës? Çështja tjetër është se si është e mundshme mos të hulumtohet edhe tregu i cigareve? Në momentin kur Qeveria kishte paralajmëruar ngritjen e akcizës, ende nuk është futë në fuqi akciza e re, ndërsa çmimi i cigareve u ngritë në momentin kur u deklarua ngritja e akcizës. Si është e mundshme me u lejuar një veprim i tillë? Sepse në këto dy drejtime ka edhe marrvëshje mafioze në shumicën e mallrave që importohen çoftë në ndërtimtari apo në mallrat tjera.

Lutfi Zharku - theksoj se i bashkëngjitet pyetjes së Beratit, lidhur me çështjen e importuesve të naftës, duke shtuar se çështja e hetimeve të çmimeve është ndal në gjysmë, dhe nuk vazhduar deri te ato që i importojnë. Edhe këtu një çështje ku mund të thuhet se tregu i karburantëve është i liberalizuar totalisht. Kështu që kush do që ka pompë të benzinës mund të importojë naftë sa të don pa kurrfar problemi. Pyeti se pse nuk është pasqyruar inkasomi i gjobave në Raport?

Ramiz Kelmendi – theksoj çështja si ajo e arkave fiskale u përmend se është gjëritë mos implementimi i arkave fiskale, sot kriminalitetin më të madh në Kosovë, më shumë i ushqenë grupet kriminale mungesa e arkave fiskale se sa vetë grupet kriminale që janë. Prandaj ishte dashur që vetë Qeveria jonë ti implementoj arkat fiskale me shpejtësi marramendëse, në mënyrë që të legalizohet tregu dhe që dihet qarkullimi i parasë së Republikës së Kosovës. Sugjeroj se si komision, këtë çështje ta ngrisim në nivel të Parlamentit, këtu ka nevoj për ndryshim plotësim të ligjeve dhe ngritje të cilësisë dhe përkrahjes të këtijë agjencionit, me agjencionin tjetër kundër Korrupcionit dhe me EULEX-in.

Kryetari - parashtroj pyetje e cila ka të bëjë lidhur me çështjen e mandatin e anëtarëve të AKK-së, puna e zgjedhjes ka pasur dallime në mes të ligjit ekzistues edhe paraprak, ta sqaroni punën e përzgjedhjes suaj? Duke marr parasysh së në adresën e Komisionit ka ardh një letër nga z.Halil Shabani, që është anëtarë i Komsionit, ku fletë për vështirësitë e funksionimit të këtijë institucioni. E kemi obligim që ta trajtojmë çdo kërkesë apo ankesë që vie nga ju në Komsionin tonë Parlamentar.

Osman Ejupi (kryesues i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës -AKK) – u përgjigj në pyetje si në vijim: tha se është e vërtet që bankat në tregun financiar të Kosovës i kanë kamatat apo normat e kamatave më të lartat në rajon, ky është një indikacion që ne i marrim nga shumë pjesëtarë të komuniteteve të biznesit që ankohen se kredit e tyre po i marrin me zor sepse nuk kanë ku të shkojnë diku tjetër se e njehta masë është si te banka e Raffaiseen-it, si te Procredi-ti dhe te bankat e tjera; edhe në fazën e dytë po ashtu dhe jemi në fazën e tretë të një vendimi ku ne po i krahazojmë të gjitha këto norma të kamatave me kamatat në regjion, kushtet ekonomike të kredive, ky është një target i hulumtimit të autoritetit, ndërsa pika e dytë ka të bëjë edhe me pozitën dominuese që dy banka nga jashtë Raiffaiseen dhe Procredit bankë, kanë gjithë masën monetare me kapital financiar, që është në të gjithë tregun e Kosovës, ne në bazë të këtyre pyetësorëve po na rezulton më shumë se 40% të kapitalit financiar në Kosovë e mbajnë Procredit dhe Riffaseen banka; në ligjin mbi Konkurrencën në momentin kur operatorët teknikë e kalojnë këtë situat ata konsiderohen se kanë arritë monopol mbi kapitilin financiar d.m.th e kanë statutin e monopolit; ne me ligj duhet ta shiqojmë se ku ata po abuzojnë me pozitën dominuese të cilët e kanë në tregun Kosovar; lidhur me marrëveshjet, ne marrëveshje mund ta konsiderojmë çdo praktikë e cila e ka për qëllim fiksimin e çmimeve apo ndarjen e tregut, ajo që potencoj z.Kelmendi, heqjen e operatorit ekonomik nga tregu me një prapavijë që ne do ta ngritim në një kohë çmimin apo do ta zvogëlojmë, deri sa ata ty mbysim në kuptimin ekonomik, e tani ne të bëjmë me tregum si duam ne edhe ti nxjerrim rezervat e atyre që ne i kemi humbur; pyetja e znj. Teuta, lidhur me aviokompanit ne nuk kemi qenë të inkuorporuar as në procesin e privatizimit të aeroportit apo të koncensionit të aeroportit të Prishtinës, ne jemi dëshmitarë se edhe këtu kemi ankesa nga komuniteti, se shpenzimet e udhëtimit nga Kosova, në rajonet tjera janë më të shtrenjta gati dyfish se sa në vendet tjera në rajon, ne kemi filluar një monitorim por ky është

një treg mjaftë kompleks i cili prapa veti ka shumë indikacione nga jashtë, ka shumë operatorë që lidhen të cilët nuk janë nga këtu kështu që ne për ta investiguar këtë treg me këtë start që kemi sigurisht që na duhet njëkohë më e gjatë, kur ishim te bankat; Për rastin e Gjilanit ne kur e hetojmë një produkt apo një treg duhet të dalim vetë në treg pra investigojmë pikat e shitjes të pompave të benzinës ne këtu jo vetëm që ka ndryshuar asnjë një cent por në ato 32 pika të shitjes nuk ka ndryshuar çmimi i shitjes për asnjë cent as i benzinës, as i naftës dhe i gazit dhe mbi të tjera edhe pse ajo nuk është relevante sepse ne e kemi një marrëveshje të shkruar në origjinal ku kemi potencuar që çmimi i gasit të jetë ky, i naftës i benzinës por edhe mos të ishte kjo ne do kishim marrë masa sepse ajo na obligon neve sepse ajo është prishje e tregut asnjë operatorë ekonomikë asnjë pompë e benzinës në asnjë regjion në asnjë qytet nuk mundet ti ketë shpenzimet e barabarta manipulative, kalkulative apo fikse me një operator tjetër dhe ajo tregon thjeshtë që këta janë marrë vesh dhe kanë bërë marrëveshje ne marrim provojë nga Sllovenia edhe nga Maqedonia, mirëpo ato janë shtete të cilat kanë nivelin më të lartë të zhvillimit; në vendet e tjera procesi i fiskalizimit është dhënë falas është kryer nga vetë shteti, të raportosh me arkat fiskale d.m.th se çdo cent që shitet në tregun e Kosovës i paguhet të gjitha shtetit kjo është mjaftë punë e madhe po të funksiononte kjo buxheti i konsoliduar i Kosovës nuk do të mirret me këto probleme të cilat po i flasim tani; që a e keni informuar Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, po ne kemi bërë një rekomandim dhe kemi thënë se ky proces si ka filluar nuk do të kryhet edhe për pesë vitet e ardhshme dhe ky proces në këtë mënyrë me një operator nuk mbaron kurrë sepse kemi monopol permanent, sepse në njërin anë inspeksioni shtron dhunë që operatorët të paisën me arka ndërsa në anën tjetër një arkë është 400 euro ku mund të them se në këtë sistem ka pasur mjaft shumë defekte dhe ato nuk na takojnë agjencionit tonë dhe në bazë të këtij raportit kemi ardhur deri te licencimi i dy operatorëve tjerë të cilët për mendimin tim ende nuk kanë filluar punën sepse në informatat të cilat ne i kemi ata nuk i kanë dorzua produktet e tyre për licencim dhe ky është problem që nuk është vetëm mi yni por është problem i të gjithë juve ne kemi dhënë tonën edhe më tutje do të mundohemi; ndërsa sa i përket gjobave ne në të dy rastet i kemi dhënë gjobat maksimale sepse në ligjin e vjetër gjoba maksimale ka qenë 100 mijë euro po të kishte më shumë nuk do ishte mëkat me i gjobit më shumë, sepse dihet se sa është ndryshimi në ato produkte këto vlejnë edhe për kompanitë e sigurimeve, vlen edhe për arkat fiskale, lidhur edhe me sigurimet nuk po e përsërisë sepse për ne ajo është marrëveshje është kartel.

Visar Ymeri – theksoj se ndërhyrja e operatorëve ilegal, po ashtu edhe hyrja e mallrave të cilat nuk doganohen në Kosovë, ato janë ndërhyrje në konkurrencë për shkak se atyre, ju kushton më lirë me ofrua shërbime ku që ndërkohë hynë në një treg. Mirëpo, konsideroj që agjencioni i juaj është dashur që ta përmend në Raport si problem i konkurrencës për të cilin jeni përgjegjës.

Hashim Deshishku – kërkoj nga AKK-ja që të sjell më shkrim përgjigje për këto pyetje: 1. Kush vendos për tarifat TPL? 2. A është siguri i detyrueshëm apo vullnetar? 3. Cili autoritet i mbikqyrë kompanitë e sigurimeve? Dhe 4. Cilat janë procedurat për ushtrim të aktivitetit të sigurimeve?

Ahmet Krasniqi (nënkryetar i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës –AKK) - ligji aktual që ka hyrë në dhjetor në fuqi, tri fusha i mbron, çdo marrëveshje pavarësisht a është e shkruar apo gojore, apo praktik e bashkërenduar, e përcakton çmimin, dhe ndan tregun. Çdo ndërmarrje publike që ka një pozitë dominuese që ka 40% të një tregu relevant, ai nuk mirret vesh për çmim por e cakton vet, por nëse është çmimi jo real, qoftë i vogël apo i lartë që ne e bëjmë krahasimin me vendet e rajonit ose me tregjet relevante. Rasti i Gekosit ka qenë i njëjti ne i kemi bërë rekomandimin Ministrisë së financave, dhe çka është marramendëse çmimi i një arke fiskale që është më i lartë se sa në vendet e rajonit. Pyetja e znj. Teuta se dënimet a mund të vihen me ligj apo me udhëzime administrative, me udhëzim administrativ mendoj se janë rrethanat më lehtësuese që mund ta zbresin në 30% mund ta falin krejt një operator apo mund ta ngrisin deri në 30% si rrethanë renduese nga 10% ose nga sa merr vendim komisioni. D.m.th rrethanat

lehtësuese dhe rënduese bëhen me udhëzim administrativ, ndërsa gjobat janë të bazuara në ligj deri në 10% maksimumi. Është e vërtetë që bankat e kanë një udhëzim administrativ udhëzimi nr.3, që rregulli 3 neni 3 është në kundërshtim edhe me ligjin për kompanitë e sigurimeve, por në këtë nen, kemi kërkuar me shfuqizua, mirëpo udhëzimet administrative të cilat janë në kundërshtim me ligjet ato nuk vlejnë sepse ai është një akt nën ligjor në kundërshtim me ligjin. Dhe ne ja kemi dhënë mundësin që me e padit Gjykate supreme ta inicioj konfliktin administrativ qysh neve na udhëzon ligji. Çmimin e një TPL-je e cakton kompania e sigurimit e dorëzon në Bankën Qendrore, banka ja miraton që është në bazë të harxhimeve të cilat i bënë analizën çdo kompanie të sigurimit. Ne i kontrollojmë marrëveshjet apo abuzimet të cilat bëhen jo çmimet, sepse çmimin e përcakton kualiteti i mallit ose i shërbimit, por çmimi duhet të jetë i ndryshueshëm.

Sala Berisha Shala - potencoj që të mos ketë paqartësi në Kuvend, AKK duhet të sjell me shkrim të gjitha këto të cilat u folën këtu, në të gjitha pyetjet sepse kishte edhe paraqitje të cilat nuk kenë të parapara në Raport.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës AKK -së, për vitin 2010.

dhe Kuvendit i parashtron këtë:

Rekomandim

1. *Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës AKK -së, për vitin 2010.*
2. *Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.*

Komisioni autorizoj Njësinë mbështetëse të Komisionit, që të mos procedoj për seance plenare Rekomandimin e Komisionit, deri në sjelljen e përgjigjeve shtesë nga AKK.

4. Të ndryshme

a) Tryeza “Përmirësimi i kornizës ligjore për përmirësimin e mjedisit biznesor”;

Kryetari – i njoftoi deputetët së më 18.05.2011 do të organizohet një Tryeze nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe ne bashkëpunim më NDI - Instituti Kombëtar Demokratik. Kjo Tryeze do të quhet: “Përmirësimi i kornizës ligjore për përmirësimin e mjedisit biznesor”.

b) Aktivitet e radhës të Komisionit;

Kryetari – i njoftoi deputetët se do të fillojmë të bëjmë vizita pune neper institucione si ministri dhe agjencitë të cilat i raportojnë Komisionit. Po ashtu njoftoi se sot se bashku me zëvendëskryetaren ka realizuar një takim me OJQ që e mbështesin Komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetari i Komisionit